



EUR 750,000

ID: 2827



VILE LUKSOZE PER SHITJE NE VISHNJE

Në periferinë e Tiranës, vetëm 15 minuta nga TEG, ka dale ne treg per shitje nje vile e ndertuar me dashuri dhe kujdes, mbi nje terren prej 1130 m². Siperfaqja e ndertimit prej 350 m² eshte e organizuar në tre kate dhe vila eshte projektuar për të ofruar komoditetin maksimal dhe nje stil modern e te ngrohete ku mund te ndihen si ne shtepi qe ne momentin e pare. Kati përdhe i viles ofron nje ambjent te bollshem ndenjeje i cili është i përkryer për të argëtuar mysafirët ose për të kaluar kohë cilësore me familjen. Me tavane te larta, dritare të mëdha qe lejojne driten e diellit te hyje gjate gjithë dites dhe rifinitura luksoze, ku vihen re dyshemetë prej druri cilesor inxhinjrik, ndriçimin e projektuar me kujdes dhe mobilimi elegant, kjo pjese e shtepise eshte edhe pasqyra me e mire e cilesise se saj. Ngjitur me dhomën e ndenjes është një kuzhinë moderne, e cila është e pajisur me elektroshtepiake të nivelit të lartë. Kuzhina të nxjerr në një verande te kendshme në natyrë, e cila është e përkryer për tavolina miqsh në freskine e mbremjeve sidomos gjate muajve te ngrohete. Në katin e sipërm, do të gjeni tre dhoma gjumi me madhësi te bollshme, dhe nje tualet per katin. Dhoma kryesore e gjumit ze pjesen me te madhe te siperfaqes se katiit ku, pervec hapesires se madhe te dhomes, gjejme gjithashtu edhe nje tualet mjaft te kendshem me vaske moderne si dhe nje dhome garderobe, endrra e cdo zonje shtepie. Por kjo nuk është e gjitha - Zbrisni shkallët dhe ne katin -1 do të gjeni veten në një hapësirë që është

projektuar duke pasur parasysh relaksin dhe argëtimin. Nje dhome e dyte ndenjeje e cila përmban një televizor me ekran të madh, rafte biblioteke dhe divane të rehatshem, duke e bërë atë vendin e përsosur për t'u çlodhur pas një dite të gjatë. Ne te njeitin kat ndodhet gjithashtu garazhi i mbyllur nentokesor per 2 makina, ambjent magazinimi, dhoma teknike dhe nje hapesire e madhe lavanderie. Ne pjesen e tokes qe i takon viles jane mbjelle shume peme frutore e eshte lene hapsire qe banori i ardhem i tyre te shprehe kreativitetin apo nevojat e tij me kopshtarine, ndertimin e nje zone barbeque apo edhe pishine...hapesira ne dispozicion jua lejon te gjitha, e rrethuar nga peizazhe të bukura që ofrojnë nje perzierje perfekte të privatësisë dhe qetësisë. Në përgjithësi, vila eshte mishërimi i rehatisë dhe stilit, duke ofruar përzierjen perfekte të jetesës ne ambjente te brendshme e te jashtme, në një vendndodhje fantastike vetem pak minuta jashtë Tiranës.



CONTACT US

 thepoint.al

 Bulevardi Gjergj Fishta
Tiranë, Albania

 +355 69 202 7070